

NDËRLIDHJA MES STRESIT TË PRINDËRVE ME SJELLJET PROBLEMATIKE TË
FËMIJËVE ME ÇRREGULLIME NEURO-ZHVILLIMORE SI DHE ROLI I PËPRUNIMIT
SHQISOR TEK SJELLJET PROBLEMATIKE

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË FUSHËN
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

nga

Erza Ramadani



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PSIKOLOGJI
PRISHTINË

MARS, 2023

Ndërlidhja mes stresit të prindërve me sjelljet problematike të fëmijëve me çrregullime neuro-zhvillimore si dhe roli i përpunimit shqisor tek sjelljet problematike.

Kandidatja: Erza Ramadani

Mentore: Prof. Ass. Dr. Kaltrina Kelmendi

Punimi është i përmbledhur në 82 faqe, brenda të cilave përfshihen shtojcat dhe burimet shkencore (literatura). Sipas formatit për punimin e temës së diplomës, i gjithë punimi është ndarë në pesë kapituj kryesorë.

Kapitulli i I-rë paraqet pjesën hyrëse të punimit, Në pjesën hyrëse të punimit, flitet rreth sjelljeve problematike tek fëmijët me vështirësi neuro-zhvillimore, reth vështirësive të përpunimit shqisor të cilat ata mund të përjetojnë, si dhe për stresin e prindërve të fëmijëve me çrregullime neuro-zhvillimore. Si pjesë të këtij kapitulli, është paraqitur edhe perspektiva teorike në të cilat është bazuar studimi. Në këtë kapitull po ashtu është realizuar përkufizimi i termave kryesorë dhe janë paraqitur pyetjet dhe hipotezat e studimit aktual të cilat ishin:

1.Çfarë ndërlidhje ekziston mes stresit prindëror, vështirësive në përpunimin shqisor dhe sjelljeve problematike tek fëmijët me çrregullime neuro-zhvillimore?

2.Si ndërlidhen sjelljet problematike të fëmijëve me çrregullime neuro-zhvillimore me stresin prindëror? :

3.Cila prej sjelljeve problematike parashikon stresin prindëror?

4. Si ndërlidhet mosha e fëmijës me stresin prindëror?

5.A ekzistojnë dallime gjinore sa i përket vështirësive në përpunim shqisor dhe në prezencën e sjelljeve problematike?

H1. Sa më shumë që kanë fëmijët vështirësi në përpunim shqisor do të kenë më shumë sjellje problematike.

H2. Sa më shumë që fëmijët kanë sjellje problematike, prindërit aq më tepër do të përjetojnë stres.

H3.Sjelljet agresive dhe vetë-lënduese tek fëmijët parashikojnë stresin më të lartë prindëror.

H4. Prindërit e fëmijëve të vegjël përjetojnë më tepër stres në krahasim me prindërit e fëmijëve të rritur.

H5. Djemtë me çrregullime neuro-zhvillimore kanë më shumë sjellje problematike dhe vështirësi në përpunim shqisor në krahasim me vajzat me çrregullime neuro-zhvillimore.

Me tutje vijon Kapitulli i II-të ku është realizuar shqyrtimi i literaturës me të gjeturat e realizuara në vende të ndryshme të botës dhe është synuar të elaborohet ndërlidhja dhe ndikimi i stresit të prindërve tek sjelljet problematike dhe po ashtu ndërlidhja mes vështirësive në përpunimin shqisor tek fëmijët dhe shfaqja e sjelljeve problematike.

Kapitulli i III-të paraqet pjesën e metodologjisë ku përfshihen dizajni i studimit, pjesëmarrësit, matjet, procedura, etika dhe analiza e të dhënave. Për realizimin e studimit është përdorur dizajni kuantitativ dhe pjesë e studimit kanë qenë 80 prindër të fëmijëve me vështirësi neuro-zhvillimore. Prindërit raportuan për sjelljet problematike të fëmijëve të tyre përmes Listës Kontrolluese të Sjelljes së Fëmijës (CBCL), ndërsa për vështirësitë në përpunim shqisor ata raportuan përmes Profilit të Shkurt Ndijor (SSP) si dhe përmes Shkallës së Stresit Prindëror (PSS) raportuan për stresin e tyre prindëror .

Në kuadër të pjesës së kapitullit të Rezultateve janë prezantuar gjetjet e hulumtimit kërkimor. Analizat dhe rezultatet janë organizuar duke respektuar hipotezat e hulumtimit, me qëllim arritjen e tyre.

Hipoteza e parë është konfirmuar ku rezultatet treguan se në mes të vështirësive të fëmijëve me përpunim shqisor dhe sjelljeve të tyre problematike ekziston korrelacion pozitiv i nivelit të moderuar dhe me domethënie statistikore, me ç'rast kur vështirësitë në përpunim shqisor rriten, sjelljet problematike rriten po ashtu.

Hipoteza e dytë e këtij studimi nuk është konfirmuar ku rezultatet treguan korrelacion pozitiv i nivelit të ulët por pa domethënie statistikore në mes të sjelljeve problematike të fëmijëve me çrregullime neuro-zhvillimore dhe nivelit të raportuar të stresit prindëror. Pra, sipas të gjeturave të këtij studimi, sjelljet problematike të fëmijëve nuk ndërlidhen me stresin prindëror.

Sa i përket hipotezës së tretë sipas të cilës sjelljet agresive tek fëmijët parashikojnë stresin më të lartë prindëror, rezultatet nga ky hulumtim tregojnë se hipoteza nuk aprovohet ku ekuacioni regresional nuk është signifikant. Në këtë mënyrë shihet se sjelljet agresive të fëmijëve me çrregullime neuro-zhvillimore nuk janë parashikues signifikant i nivelit të stresit prindëror.

Hipoteza e katërt e këtij hulumtimi u aprovua ku u analizua nëse ka dallime në stresin prindëror në mes të prindërve që kanë fëmijë me të vegjël se 6 vjeç dhe prindërve që kanë fëmijë me të mëdhenj së 6 vjeç. Të gjeturat janë se ekzistojnë dallime në nivelin e raportuar të stresit prindëror, ku prindërit që kanë fëmijë të moshës më të vegjël së 6 vjeç raportojnë nivele më të larta të stresit prindëror në krahasim me prindërit e fëmijëve me të mëdhenj së 6 vjeç.

Hipoteza e fundit e këtij hulumtimi nuk u aprovua ku thuhet se djemtë me çrregullime neuro-zhvillimore kanë më shumë sjellje problematike dhe vështirësi në përpunim shqisor në krahasim me vajzat me çrregullime neuro-zhvillimore. Në bazë të studimit tonë shihet se vajzat rezultojnë më lartë në mesatare sesa djemtë për vështirësitë në përpunim shqisor dhe sjellje problematike dhe këto dallime nuk janë signifikante.

Në kapitullin e pestë, pasi që janë paraqitur rezultatet në mënyrë të detajuar, është vazhduar më pjesën e diskutimit të rezultateve, ku është bërë prezantimi i të gjeturave në mënyrë të përmbledhur duke ripotencuar dhe diskutuar të gjeturat në mbështetje të literaturës të parashqyrtuar, po ashtu duke prezantuar limitimet shkencore të studimit, të mbështetura me të dhëna konkrete për hulumtimet e radhës.